



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 108, dt. 01.06.2015

Në mbështetje të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 01.06.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit të restaurimit të Kishës së Shën Mërisë, Barmash, Ersekë.
Projekti përfshin dhe ndërhyrjen konservuese-restauruese në pikturën murale të kishës “Shën Mëria”, Barmash, Ersekë.
2. Të bëhet një projekt për ndërhyrjen emergjente të konsolidimit të mureve të kishës si dhe të vendosjes së një strukture të përkohëshme mbuluese për mbrojtje nga agjentët atmosferikë.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

